



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

**Legjislatura VI**  
**Sesioni Pranveror**

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike  
Mbledhja nr. 36  
Prishtinë, më 15 Shkurt 2019, në orën 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-302

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Driton Selmanaj, Mërgim Lushtaku, Albert Kinolli, Avdullah Hoti, Emilija Rexhepi dhe Andin Hoti.

**Munguan:** Faton Topalli, Valon Ramadani, Etem Arifi, Ali Lajçi dhe Verica Qeraniç.

**Stafi mbështetës:** Antigona Ibraj, Mehmet Simnica dhe Ajet Avdullahu.

**Pjesëmarrësit e tjerë:** Sami Kurteshi, deputet nga VV, Fatmir Gashi dhe Ahmet Ismaili nga MF, Shkëlqim Xhema, Qerkin Morina dhe Violeta Smajlaj nga ZKA-ja, Arton Demhasaj nga ÇOHU, Loren Hyseni nga KDI-ja dhe Nehat Dervishi nga OSBE.

**Mbledhjen e kryesoi:** Driton Selmanaj, kryetar i komisionit.

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23.01.2019;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Borxheve Publike për periudhën 2009-2017;**
- 4. Inicimi i procedurave për Auditimin e raporteve financiare të Subjekteve Politike, për vitin 2018;**
- 5. Të ndryshme.**

*Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.*

### 1. **Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

### 2. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23.01.2019**

*Procesverbali i mbledhjes, të mbajtur më 23.01.2019, u miratua pa vërejtje.*

### 3. **Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrolllet e Borxheve Publike për periudhën 2009-2017**

**Kryetari** njoftoi deputetët se bazuar në planin e punës së komisionit për vitin 2019 ne kemi bërë ndarjen e raporteve të auditimit për raportuesit sipas planit të punës së Komisionit për vitin 2019. Raportues për Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrolllet e Borxheve Publike për periudhën 2009-2017 është z. Avdullah Hoti. Me këtë e hapi diskutimin.

**Avdullah Hoti** theksoi se raporti i auditimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrolllet e Borxheve Publike për periudhën 2009-2017, raport ky i përgatitur nga Zyra Kombëtare e Auditimit. Borxhi publik ka filluar të merret nga institucionet tona nga viti 2009, për herë të parë nga Banka Botërore. Deri në fund të vitit 2017 borxhi publik kap shifrën mbi 1 miliard euro apo shprehur në përqindje 16.63%. Pra kjo % është dukshëm nën nivelin e lejuar të Borxhit Publik që është e lejuar deri në 40% të BPV. Ministri i financave ka arritur të mbajë në kontroll borxhin publik pranë, nën nivelin e lejuar, dhe pjesa dërmuese e borxhit është në valutën euro e që nuk afektohet nga influenza e lëvizjeve të valutave në tregjet botërore. Pra, vetëm 16% e Borxhit Publik është në valuta tjera. Bazuar në raportin e auditimit, ZKA ka evidentuar vonesa në fillimin e proceduarave për marrjen e borxhit publik, kjo vonesë është bërë nga MPJ, vetëm në një rast. Sipas legjislacionit në fuqi kërkohet nga MPJ- ja të lejojë fillimin e proceduarave për marrjen e borxhit publik. E gjetura e dytë ka të bëjë me mospërputhjen në kopje në shqip me atë anglisht marrëveshjen për financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin e Reformës Shëndetësore në vlerë 18,613,139€, e ratifikuar në Kuvend më 26 mars 2015, në tekstin e gjuhës angleze neni II -Financimi, paragrafi 2.05, parasheh një normë interesi prej 1.25%. Por, ky nen nuk ekziston edhe në tekstin e gjuhës shqipe. E gjetur tjetër ka të bëjë me mos shfrytëzimin e mjeteve të marra në formë të borxhit publik, por kjo është në nivel të përgjegjësive të institucioneve që kanë të bëjnë shfrytëzimin e këtyre mjeteve, e jo nga ana e Ministrisë së Financave. Borxhi ndërkombëtar i ratifikuar deri në fund të vitit 2017 është 1,080,000,000 euro. Prej tyre mjete të tërhequra janë 784,660,000 euro, ndërsa në mungesë të përgatitjeve të duhura për fillimin e ekzekutimit të projekteve, vlera e pa tërhequr e kredive deri në fund të vitit 2017 ishte 295,800,000 euro. Dhe si rezultat i kësaj, Qeveria e Kosovës është duke paguar tarifë të zotimit për vlerën e mjeteve të zotuar të cilat nuk i ka tërhequr. Vlera e paguar e tarifave të zotimit për mjetet e kredive të pa tërhequra nga huamarrësit është 890,000 euro. Po ashtu një shumë prej 10% të borxhit publik ne ende nuk e kemi trashëguar nga Klubi i Parisit, por kjo mund të bëhet me vonë. Ne po ashtu në material kemi strategjinë e borxhit publik 2019-2021 e cila ka pasur parasysh objektivat e caktuara për borxhin publik.

**Sami Kurteshi** pyeti zëvendësministrin Gashi, për këtë zotim të mjeteve, ne paguajmë një lloj tarife për mos shfrytëzimin e këtyre mjeteve. A jep dikush llogari për këtë çështje dhe kush është përgjegjës? Pse janë kërkuar këto mjete dhe nuk shfrytëzohen? A ka ndonjë projekt apo plan paraprakisht para se të kërkoen këto mjete, apo vetëm të kërkoen edhe të paguajmë një tarifë vjetore shumë të lartë?, sepse këto tarifa që i paguajmë janë para të qytetarëve.

**Zëvendësministri Fatmir Gashi**, tha se sa i përket borxheve publike do të jenë shumë më efikas, ashtu si edhe në shfrytëzimin e mjeteve ku do të jenë shumë më aktivë. Në këtë raport u konstatua se MF ka respektuar limitin e lejuar të hyrjes në borxh dhe se trendi i zhvillimit të borxhit shtetëror nuk paraqet ndonjë kërcënim për stabilitetin financiar të vendit. Është konstatuar edhe MF është mjaft efektive në evidentimin, procesimin, regjistrimin dhe raportimin e borxheve publike, si dhe respektimin e marrëveshjeve të borxheve publike sipas afateve të përcaktuara. Kemi arritur në mënyrë të kënaqshme dhe në kohë të realizojmë planin e zbatimit të rekomandimeve dhe të avancojmë më tutje në fushën e borxhit publik që është në nivelet e planifikuara dhe në përputhje me programin e borxhit publik. Borxhi publik në fund të vitit 2018 ishte 12 për qind. Nëse e shohim 2017, 2016, 2018 e shihni që shumë kujdes kemi në hyrjen në borxhe, sidomos sa i përket shfrytëzimit të mjeteve është një sfidë e cila edhe neve na mundon. Dhe theksoj se me ndryshimin e Ligjit për Borxhin Publik do të ngritët përgjegjësia dhe dy herë në vit do raportojmë në Qeveri në lidhje me statusin e borxheve publike ku gjendet dhe Qeveria. Në këtë raport prezantohet se MF ka respektuar hapat që ka ndërmarrë. Kjo është pasqyra nga Ministria e Financave për të gjeturat e raportit të Auditimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrolllet e Borxheve Publike për periudhën 2009-2017.

**Kryetari**, pasi nuk pati diskutim në këtë pikë propozoi këtë përfundim.

#### *Përfundim*

*KMFP, vendosi që Raporti i Auditimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrolllet e Borxheve Publike për periudhën 2009-2017, të mos adresohet për Seancë Plenare. Rekomandimet e mundshme do të diskutohen në mbledhje të radhës së komisionit dhe të njëjtat do ti dorëzohen Ministrisë së Financave.*

#### **4. Inicimi i procedurave për Auditimin e raporteve financiare të Subjekteve Politike, për vitin 2018**

**Kryetari** njoftoi deputetët se administrata ka përgatitur shkresën bazuar në Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike, bëhet fjalë për fillimin e procedurave për Auditimin e raporteve financiare të Subjekteve Politike për vitin 2018.

#### *Përfundim*

*KMFP, vendosi që të Autorizohet Administrata e Kuvendit, të ndërmarrë veprimet e nevojshme për thirrje të hapur për aplikim, për përzgjedhjen e së paku 10 auditorëve të licencuar, të cilët do të auditojnë Raportet Vjetore Financiare të Subjekteve Politike, për vitin 2018.*

#### **5. Të ndryshme**

**Kryetari** pyeti se me rastin e festimit të 11 vjetorit të pavarësisë është ndarë një shumë prej 500 mijë euro, në krahasim me vitin 2017, e që ka qenë përvjetor jubilar janë ndarë 70 mijë euro. Pse kjo shumë e mjeteve nuk është planifikuar më herët, kur dihet data e Pavarësisë? Pse gjithë kjo shumë. Për ne rritja dhjetëfish e shpenzimeve, cilat aktivitete kanë qenë më shumë se në vitin e kaluar, sa kam vërejtur unë përpos një koncerti të tjerat shpenzime nuk e di si t'i arsyetojë? Me këtë e hapi diskutimin.

**Zëvendësministri Fatmir Gashi** tha se nuk mund të përgjigjem pasi nuk është në kompetencën time. Është vendim i Qeverisë dhe tash unë me e arsyetuar apo me kritikuar nuk më takon. Është vendim që është marrë prej të gjithë Kabinetit Qeveritar.

### *Përfundim*

*KMFP vendosi që në njërin nga mbledhjet e radhës së komisionit të ftohet Kryeministri i Kosovës për të arsyetuar vendimet për zbrazjen e programit (232), shpenzimet e paparashikuara nga kategoria ekonomike e rezervave.*

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

**E përgatiti:**  
**Stafi mbështetës i komisionit**

**Kryetari i komisionit,**

---

**Driton Selmanaj**